

Rezultatet paraprake të Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve, 2018

Tiranë, më 11 nëntor 2019: Në vitin 2018, ndërmarrjet që operojnë në aktivitetet e prodhimit të të mirave dhe shërbimeve realizuan 2.179 miliardë lekë shitje neto, duke shënuar një rritje me 7,0 %, krahasuar me vitin 2017. Investimet e realizuara arritën vlerën 238 miliardë lekë nga 232 miliardë lekë në 2017, duke shënuar një rritje prej 2,8 %. Në vitin 2018, operuan 107.450 ndërmarrje aktive, duke u ulur me 0,2 %, krahasuar me vitin 2017, ndërsa numri gjithsej i të punësuarve u rrit me 4,6 %.

Tab.1 Treguesit kryesorë sipas aktiviteteve ekonomike, 2018


Aktiviteti ekonomik	Ndërmarrjet		Të punësuarit		Shitjet neto		Investimet	
	nr.	Struktura %	nr.	Struktura %	mIn Lekë	Struktura %	mIn Lekë	Struktura %
Gjithsej	107.450	100,0	515.727	100,0	2.179.320	100,0	238.272	100,0
Prodhuesit e të mirave	13.559	12,6	184.750	35,8	738.231	33,9	148.079	62,1
Industri nxjerrëse	646	0,6	11.552	2,2	77.580	3,6	18.494	7,8
Industri përpunuese	8.668	8,1	106.316	20,6	253.304	11,6	33.131	13,9
En. elek., ujë. trajt.mbetjeve	637	0,6	21.815	4,2	152.379	7,0	54.626	22,9
Ndërtim	3.608	3,4	45.066	8,7	254.968	11,7	41.829	17,6
Prodhuesit e shërbimeve	93.892	87,4	330.977	64,2	1.441.089	66,1	90.193	37,9
Tregti	44.442	41,4	125.350	24,3	986.907	45,3	43.577	18,3
Akomodim dhe Restorante	18.966	17,7	56.175	10,9	61.260	2,8	7.311	3,1
Transp.Kom.	7.654	7,1	38.236	7,4	155.649	7,1	15.227	6,4
Shërbime të tjera	22.830	21,2	111.216	21,6	237.273	10,9	24.078	10,1

Komente mbi treguesit kryesorë

Bazuar në rezultatet paraprake të Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve, kontributin më të madh në rritjen prej 7,0 % të **shitjeve neto** e dhanë prodhuesit e shërbimeve me +4,1 pikë përqindje, të ndjekur nga prodhuesit e të mirave me +2,9 pikë përqindje. Gjatë vitit 2018, sektori i tregtisë zë peshën më të lartë të

shitjeve neto me 45,3 %, i ndjekur nga sektori i ndërtimit me 11,7 %. Sektorët me peshën më të vogël janë sektori i akomodimit dhe restoranteve (2,8 %) dhe sektori i industrisë nxjerrëse (3,6 %).

Fig.1 Kontributi i aktiviteteve ekonomike në ndryshimin e shitjeve neto, 2018/2017 (p.p)




Situatë e ngjashme paraqitet për treguesin e **punësimit**. Në rritjen prej 4,6 % të punësimit, prodhuesit e shërbimeve dhanë kontributin më të madh me +3,1 pikë përqindje, ndërsa prodhuesit e të mirave kontribuan me +1,5 pikë përqindje. Sektorët me peshën më të lartë të punësimit për vitin 2018 janë sektori i tregtisë me 24,3 % të punësimit, sektori i shërbimeve të tjera (arsimi dhe shëndetësia private, shërbime administrative, profesionale, shkencore dhe teknike, etj.) me 21,6 %, të ndjekura nga sektori i industrisë përpunuese me 20,6 % të të punësuarve gjithsej.

Gjatë vitit 2018, **investimet** e realizuara u rritën me 2,8 %, ku prodhuesit e shërbimeve kontribuan pozitivisht me 8,0 pikë përqindje, ndërsa prodhuesit e të mirave kontribuan negativisht me 5,2 pikë përqindje. Prodhuesit e shërbimeve zunë 37,9 % të investimeve, nga 30,7 % që zinin vitin e kaluar. Sektori me vlerën më të lartë të investimeve të realizuara është ai i energjisë elektrike dhe ujit, i cili për vitin 2018 ka investuar 54 miliardë lekë, duke zënë 22,9 % të investimeve gjithsej. Peshën më të vogël të investimeve e zënë sektorët e akomodim dhe restorante (3,1 %) dhe transport dhe komunikacion (6,4 %).

Numri i ndërmarrjeve aktive për vitin 2018 u ul me 0,2 %. Në uljen e numrit të ndërmarrjeve aktive, prodhuesit e shërbimeve dhe të mirave kontribuan negativisht me nga 0,1 pikë përqindje. Sektori me numrin më të madh të ndërmarrjeve është ai i tregtisë (41,4 %), i ndjekur nga sektori i shërbimeve të tjera (21,2 %) dhe sektori i akomodimit dhe restoranteve (17,7 %). Gjatë vitit 2018, sektori i industrisë nxjerrëse pati numrin më të vogël të ndërmarrjeve aktive të cilat zunë 0,6 % të ndërmarrjeve aktive gjithsej.

Fig.2 Kontributi i prodhuesve të të mirave dhe shërbimeve në ndryshimin vjetor të treguesve kryesorë, 2018/2017 (p.p)



Komente sipas madhësisë së ndërmarrjeve


Gjatë vitit 2018, nga vrojtimi rezultojnë se *ndërmarrjet me 50 e më shumë* të punësuar japin kontributin kryesorë në ekonomi dhe realizuan 48,5 % të shitjeve neto, 42,2 % të të punësuarve gjithsej dhe 60,5 % të investimeve edhe pse përbëjnë vetëm 1,2 % të ndërmarrjeve aktive.

Tab. 2 Treguesit kryesorë sipas madhësisë së ndërmarrjeve, 2018

	Ndërmarrjet		Të punësuarit		Shitjet neto		Investimet	
	nr.	%	nr.	%	mln Lekë	%	mln Lekë	%
Gjithsej	107.450	100,0	515.727	100,0	2.179.320	100,0	238.272	100,0
1-4 të punësuar	94.008	87,5	151.831	29,4	248.849	11,4	25.518	10,7
5-9 të punësuar	6.873	6,4	43.247	8,4	158.844	7,3	5.906	2,5
10-49 të punësuar	5.241	4,9	102.849	19,9	714.577	32,8	62.578	26,3
50+ të punësuar	1.328	1,2	217.799	42,2	1.057.051	48,5	144.270	60,5

Nga rezultatet paraprake të Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve vërehet se *ndërmarrjet me 50 e më shumë* të punësuar kanë kontributin më të madh të shitjeve neto me +5,0 pikë përqindje, të ndjekura nga *ndërmarrjet me 10-49 të punësuar* me +2,4 pikë përqindje në ndryshimin vjetor gjithsej të shitjeve neto.

Fig.3 Kontributi i ndërmarrjeve sipas madhësisë, në ndryshimin e shitjeve neto, 2018/2017 (p.p)



Komente mbi aktivitetet ekonomike dhe madhësisë së ndërmarrjeve

Në prodhuesit e të mirave, numri i ndërmarrjeve ka pësuar rënie me 1,0 %, krahasuar me vitin 2017, numri i të punësuarve është rritur me 4,3 %, shitjet neto janë rritur me 8,6 %, ndërsa investimet janë ulur me 7,6 %.

Gjatë vitit 2018, ndërmarrjet me 50 e më shumë të punësuar zunë 5,3 % të ndërmarrjeve prodhuese të të mirave dhe realizuan 67,1 % të shitjeve neto. Numri i të punësuarve në këtë grup zuri 64,0 % të të punësuarve në prodhuesit e të mirave, ndërsa investimet arritën vlerën 108 miliardë lekë dhe përbëjnë 72,9 % të investimeve të prodhuesve të të mirave. Gjatë vitit 2018, ndërmarrjet në grupin me 1-4 të punësuar përfaqësuan 69,3 % të ndërmarrjeve dhe punësuan 9,7 % të të punësuarve, të prodhuesve të të mirave. Ky grup ndërmarrjesh realizoi 4,5 % të shitjeve neto dhe 3,0 % të investimeve për prodhuesit e të mirave.

Tab. 3 Treguesit kryesorë në prodhuesit e të mirave sipas madhësisë së ndërmarrjeve, 2018

Prodhuesit e të mirave	Ndërmarrjet		Të punësuarit		Shitjet neto		Investimet	
	nr.	%	nr.	%	mIn Lekë	%	mIn Lekë	%
Gjithsej	13.559	100,0	184.750	100,0	738.231	100,0	148.079	100,0
1-4 të punësuar	9.400	69,3	17.887	9,7	33.269	4,5	4.501	3,0
5-9 të punësuar	1.624	12,0	10.376	5,6	42.793	5,8	3.591	2,5
10-49 të punësuar	1.815	13,4	38.164	20,7	167.047	22,6	32.011	21,6
50+ të punësuar	720	5,3	118.323	64,0	495.122	67,1	107.977	72,9

Në prodhuesit e shërbimeve, numri i ndërmarrjeve ka pësuar rënie me 0,1 %, krahasuar me vitin 2017, ndërsa treguesit e tjerë kanë shënuar rritje të numrit të të punësuarve me 4,8 %, shitjet neto me 6,1 % dhe investimet me 26,1 %.

Gjatë vitit 2018, ndërmarrjet me 50 e më shumë të punësuar përbëjnë 0,6 % të ndërmarrjeve aktive në prodhuesit e shërbimeve dhe realizuan 39,0 % të shitjeve neto. Në këtë grup investimet arritën vlerën 36 miliardë lekë dhe përbënë 40,2 % të investimeve. Ndërmarrjet në grupin me 1-4 të punësuar përfaqësuan 90,1 % të ndërmarrjeve aktive, punësuan 40,5 % të të punësuarve të prodhuesve të shërbimeve dhe arritën vlerën prej 21 miliardë lekë investime, duke përbërë 23,3 % të investimeve të realizuara nga prodhuesit e shërbimeve.

Tab. 4 Treguesit kryesorë në prodhuesit e shërbimeve sipas madhësisë së ndërmarrjeve, 2018

Prodhuesit e Shërbimeve	Ndërmarrjet		Të punësuarit		Shitjet neto		Investimet	
	nr.	%	nr.	%	mIn Lekë	%	mIn Lekë	%
Gjithsej	93.892	100,0	330.977	100,0	1.441.089	100,0	90.193	100,0
1-4 të punësuar	84.609	90,1	133.944	40,5	215.580	15,0	21.017	23,3
5-9 të punësuar	5.250	5,6	32.871	9,9	116.051	8,1	2.316	2,6
10-49 të punësuar	3.425	3,6	64.685	19,5	547.529	38,0	30.566	33,9
50+ të punësuar	608	0,6	99.476	30,1	561.929	39,0	36.294	40,2

Metodologjia

Statistikat strukturore të ndërmarrjeve kanë si qëllim të tregojnë strukturën e ndërmarrjeve sipas aktiviteteve ekonomike nëpërmjet të dhënave bazë. Treguesit paraqiten për aktivitetet ekonomike gjithsej, sipas degëve dhe sipas madhësisë së ndërmarrjeve. Statistikat përfshijnë gjithë ndërmarrjet që prodhojnë të mira e shërbime në Shqipëri, për të gjitha format legale (nuk përfshihen aktivitetet e bujqësisë, peshkimit, aktivitetet e ndërmjetësimit monetar dhe financiar, administrata publike dhe e mbrojtjes si edhe aktivitetet e organizatave ndërkombëtare). Popullsia është bazuar në ndërmarrjet të cilat sipas regjistrimit statistikor janë aktive në dhjetor të vitit referues. Klasifikimi i ndërmarrjeve është bërë sipas Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, NVE Rev.2. Të dhënat i përkasin periudhës vjetore kalendarike. Viti fiskal korrespondon me vitin kalendarik. Klasifikimi i ndërmarrjeve sipas madhësisë është bërë sipas numrit të të punësuarve (matur si të punësuar me kohë të plotë). Për ndërmarrjet me 1-9 të punësuar është marrë mostër me zgjedhje për anketim. Ndërmarrjet me 10 e më shumë të punësuar janë anketuar tërësisht. Grumbullimi i të dhënave është kryer me intervistim të drejtpërdrejtë pranë ndërmarrjeve. Për më shumë informacion metodologjik referohuni link-ut:

<http://www.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-sh%C3%ABrbimet/statistikat-strukturore-%C3%AB-nd%C3%ABmarrjeve-ekonomike/>

Rezultatet e statistikave strukturore të ndërmarrjeve në mënyrë që të jenë të përshtatshme me ato të vendeve evropiane, publikohen duke zbatuar rregulloret e reja të Komisionit Evropian:

Rregulloren e Komisionit Evropian Nr.1893/2006 mbi “Implementimin e Nomenklaturës së Veprimtarive Ekonomike, NVE Rev.2 në Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve;

Rregulloren e Komisionit Evropian Nr.295/2008 mbi “Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve”;

Rregulloren e Komisionit Evropian Nr.250/2009 mbi “Definicionet e përdorura në Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve”.

Rezultatet e Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve, 2018 publikohen sipas Nomenklaturës së Veprimtarisë Ekonomike Rev.2. Për më shumë informacion referohuni link-ut:

<http://www.instat.gov.al/al/dokumentimi/klasifikime-nomenklatura/>

Aktivitetet ekonomike të vrojtuara

	NVE Rev.2	Aktivitetet ekonomike të vrojtuara
Seksioni	Përshkrimi	
A	Bujqësi, pyje dhe peshkim	-
B	Industri nxjerrëse	Industri nxjerrëse
C	Industri përpunuese	Industri përpunuese
D	Energjia elektrike, furnizimi me gaz, avull dhe ajër i kondicionuar	Energji Elektrike dhe Ujë
E	Furnizimi me ujë, aktivitete të trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	
F	Ndërtim	Ndërtim
G	Tregti me shumicë dhe pakicë. riparimi i automobilave dhe motoçikletave	Tregti
I	Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit	Akomodim dhe Restorante
H	Transport dhe magazinim	Transp.Kom.
J	Informacioni dhe komunikacioni	
K	Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	-
L	Pasuritë e patundshme	Shërbime të tjera
M	Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike	
N	Shërbime administrative dhe mbështetëse	
O	Administrimi publik dhe i mbrojtjes; sigurimi social i detyrueshëm	-
P	Arsimi	Shërbime të tjera
Q	Shëndetësia dhe aktivitete të punës sociale	
R	Art, argëtim dhe zbavitje	
S	Aktivitete të tjera shërbimi	Shërbime të tjera (përfshirë S94)
T	Shërbime në shtëpi	Shërbime të tjera
U	Aktivitete të organizatave ndërkombëtare	-

Rishikimi i të dhënave

Rezultatet paraprake të statistikave strukturore të ndërmarrjeve sipas Anketës Strukturore të Ndërmarrjeve publikohen 11 muaj pas mbylljes së periudhës referuese. Rezultatet përfundimtare publikohen 14 muaj pas mbylljes së periudhës referuese.

Të dhënat paraprake deri në publikimin e rezultateve përfundimtare janë në proces rishikimi. Rishikimi nënkupton plotësimin e vazhdueshëm të të dhënave. Saktësia e të dhënave të publikuara mund të rritet si pasojë e ndryshimeve që mundësohen nga sigurimi i të dhënave të reja më të plota dhe më cilësore, të cilat kontribuojnë në përmirësimin e rezultateve paraprake, të publikuara sipas afateve të parapërcaktuara në kalendarin e publikimeve.

Përkufizimet kryesore

Ndërmarrja

Ndërmarrja është njësi më e vogël e kombinimit të njësisë legale me njësinë e prodhimit të produkteve ose shërbimeve e cila ka pavarësi në vendim-marrje, sidomos për përdorimin e burimeve të saj materiale e monetare. Një ndërmarrje mund të ushtrojë një ose disa aktivitete ekonomike.

Shitjet neto

Shitjet neto përfshijnë shumat e faturuara për të gjithë aktivitetin e kryer nga njësi që vrojtohet për periudhën referuese dhe kjo korrespondon me vlerën e shitjes së mallrave dhe shërbimeve të tretëve, duke përjashtuar taksën mbi vlerën e shtuar. Ky variabël mund të gjendet në botimet e tjera me termat: shifra e afarizmit ose xhiro.

Numri i të punësuarve

Numri i të punësuarve përfshin të gjithë personat që punojnë në ndërmarrje përfshirë pronarët, të punësuarit me pagesë si dhe pjesëtarët e familjes të papaguar.

Investimet

Investimet gjatë periudhës referuese përfaqësojnë vlerën e mallrave afatgjata të blera prej ndërmarrjeve ose të krijuara për llogari të vet me qëllim përdorimi për një periudhë jo më të vogël se 1 vit në procesin e prodhimit, përfshirë tokën.